

K.B.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 19368 Prot

Lezhë, më 06 / 12 /2022

VENDIM

Nr. 128, Datë 02 . 12 .2022

“Për miratimin e ndihmës financiare për Z. Zef Pjeter Doda nga fondi i emergjencës”

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të ligjit Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM Nr.329, dt.16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, dhe kërkesës së paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile, mbi dëmin e shkaktuar në banesën e z. Z. P. D., banor në Lezhë, Bashkia Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

1. Miratimin e ndihmës financiare për Z. Zef Pjeter Doda, nr ID G809231151, banor në Lezhë, Bashkia Lezhë nga fondi i emergjencës në shumën prej 187206,5 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË

SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË MBROJTJES CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 885/1 Prot.

Lezhë, më 07.12.2022

Lënda: Konfirmim vendimi.

KËSHILLIT TË BASHKISË

KRYETARIT TË BASHKISË

LEZHË

Bazuar në ligjin nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pika 2/b; në ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjes vendore", neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, 1.1, gërma 'b', neni 54, gërma 'n'; neni 55; në ligjin nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", neni 41, si dhe në VKM nr.329, datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", **konfirmoj** bazueshmërinë ligjore të **Vendimit nr.128**, datë 02.12.2022, "Për miratimin e ndihmës financiare për z. Zef Pjetër Doda, nga fondi i emergjencës", bashkia Lezhë.

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

